

Vendim nr. 173, datë 28.05.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sandër Beci,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 28.05.2026 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 14 (E) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ELDA HAJDARI, ADRIANO HAJDARI**, përfaqësuar nga avokati Aldi Kaçi, me prokurë të përgjithshme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-4117, datë 18.11.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 28, 29, 30, 39, 42 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit rezulton se kanë ndërtuar një ndërtesë të tipit “garazh” në qytetin e Elbasanit. Po ashtu, rezulton se ndërmjet kësaj ndërtese të kërkuesve dhe një pasurie të paluajtshme të shtetasit M.U. (paditësi në gjykimin e zakonshëm) ka një mbivendosje 15 m². Për këtë arsye, shtetasi M.U. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me kërkesëpadinë me objekt: lirim dhe dorëzimin e sendit (truall) dhe kthimin e tij në gjendjen e mëparshme; shpërblimin e dëmit për përdorim të sendit; sigurimin e padisë; pezullimin e punimeve që kryhen prej të paditurve (kërkuesve).

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 2145 (13-2009-7021), datë 23.09.2009, ka vendosur: “Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë. Detyrimin e kërkuesve që t’i lirojnë e t’i dorëzojnë paditësit truallin 29.8 m², të ndodhur në lagjen Beqir Dardha. Detyrimin e të paditurve që t’i paguajnë paditësit vlerën e shfrytëzimit të sendit në shumën 104.832 (njëqind e katërmijë e tetë qind e tridhjetë e dy mijë) lekë”. Sipas asaj gjykate, trualli ku kanë bërë ndërtim të paditurit (kërkuesit) quhet truall i zënë në kuptim të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, sipas të cilit trualli i zënë me ndërtime para hyrjes në fuqi të tij nuk i kthehet ish-pronarit, por ai kompensohet për truallin e zënë me ndërtime. Në vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë, ekspertët kanë përcaktuar pronën e paditësit me sipërfaqe 200 m², prej së cilës rezulton se të paditurit kanë zënë në pronën e tij sipërfaqen e truallit 44.80 m², ku 15 m² janë zënë nga ndërtesa njëkatëshe dhe 29.80 m² janë zënë si shesh e rrugë. Për rrjedhojë, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se të paditurit (kërkuesit) mbajnë në mënyrë të paligjshme pjesën e truallit prej 29,80 m², të pazënë nga ndërtesa ku paditësi është pronar. Në përfundim, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se ekspertët, mbështetur në kushtet e tregut, kanë përcaktuar vlerën e qirasë së truallit, duke vlerësuar se të paditurit duhet të paguajnë detyrimin për shpërblim për përdorimin e sendit për periudhën për tre vjet, nga data 24.09.2006 deri më datë 23.09.2009. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë kanë bërë ankim palët në proces.

3. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 508/10-2012-2023, datë 26.06.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 2145 (13-2009-7021), datë 23.09.2009 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Elbasan.

4. Mbi rekursin e palës paditëse, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.191, datë 15.04.2015, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 508/10-2012-1023, datë 26.06.2012 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

5. Në rigjykim, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 963, datë 01.11.2016, ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. 2145 (13-2009-7021), datë 23.09.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe pranimin e padisë së paditësit. Detyrimin e të paditurve që t’i

lirojnë e dorëzojnë truallin 41 m². Detyrimin e të paditurve që t'i paguajnë paditësit vlerën e shfrytëzimit të sendit në shumën 70 lekë m² për muaj, duke filluar nga data 12.02.2008 e në vazhdim". Sipas gjykatës së apelit, në vlerësimin tërësor të provave të administruara në procesin e gjykimit dhe të rigjykitimit të çështjes, sipërfaqja prej 200 m², pronë e paditësit, krijon mbivendosje me pronën e të paditurve prej 41 m², dhe provohet qartë se kjo e fundit i është zënë paditësit prej të paditurve. Për këtë arsye, sipas gjykatës së apelit, të paditurit duhet t'i kthejnë paditësit sipërfaqen 41 m², referuar kërkesave të nenit 163 të Kodit Civil (KC), pasi është provuar se të paditurit për pronën, objekt gjykimi, janë posedues të paligjshëm, në kuptim të përcaktimeve të nenit 296 të KC-së, dhe paditësi për sipërfaqen 200 m² është pronar i ligjshëm. Në përfundim, gjykata e apelit ka vlerësuar se të paditurit duhet t'i paguajnë paditësit vlerën e shfrytëzimit të sendit, me shumën 70 lekë për muaj, duke filluar nga data 12.06.2008 e në vazhdim. Ndaj vendimit të gjykatës së apelit kanë paraqitur rekurs kërkuessit.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-4117, datë 18.11.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, për shkak se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC). Sipas Kolegjit Civil, nga gjykatat më të ulëta janë respektuar normat procedurale dhe palëve iu është dhënë mundësia të realizojnë të drejtën e tyre të mbrojtjes, të paraqesin prova, të njihen me provat e palës kundërshtare, të debatojnë në lidhje me to dhe të shprehin qëndrimin për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, duke respektuar të gjitha parimet e një procesi të rregullt ligjor. Për sa u përket pretendimeve të të paditurve (kërkuessve) për papajtueshmëri të ekspertit H.B., Kolegji Civil ka arsyetuar se nuk rezulton që ata të kenë paraqitur shkaqe objektive nga ato që parashikohen në nenet 72 e vijues të KPC-së. Ndërsa për sa i përket ekspertit tjetër të zëvendësuar, Kolegji Civil ka arsyetuar se rezulton se shkaqet e papajtueshmërisë kanë ndodhur kohë më vonë sesa ai kishte realizuar aktin e ekspertimit në gjykatën e shkallës së parë, por, megjithatë, gjykata e apelit ka bërë zëvendësimin e tij. Në vlerësimin e Kolegjit Civil gjykata e apelit i ka debatuar qëndrimet e palëve në raport me aktet e ekspertimit të marra në gjykim dhe është gjykata e faktit ajo që vlerëson se cili nga aktet e ekspertimit i afrohet më shumë aspekteve teknike të vendndodhjes e të mbivendosjes së pasurive të pretenduara nga palët. Në përfundim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se nga ana e gjykatës së apelit janë respektuar dhe zbatuar drejt dispozitat e ligjit material për zgjidhjen e çështjes në themel dhe është bërë një cilësim i drejtë i fakteve dhe rrethanave që lidhen me mosmarrëveshjen, duke u kryer një analizë juridike e plotë e provave dhe duke u zgjidhur mosmarrëveshja në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

7. Në datën 18.03.2026 kërkuessit kanë paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), i cili është regjistruar në të njëjtën datë.

II

Pretendimet e kërkuësve

8. Kërkuësit, në mënyrë të përmblëdhur, kanë pretenduar se:

- 8.1. *Parimi i paanshmërisë*, pasi eksperti H.B., i caktuar nga gjykata e apelit në rigjykimin e çështjes, ishte në kushtet e papajtueshmërisë, pasi e ka dhënë më parë mendimin e tij gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë. Gjatë gjykimit në gjykatën e apelit, eksperti H.B. ka paraqitur akt të ri ekspertimi dhe jo të njëjtin akt të paraqitur në gjykatën e shkallës së parë. Ky ekspert është caktuar nga gjykata e apelit në kundërshtim me dispozitat e ligjit procedural civil. Po ashtu, gjykata e apelit, me kërkesë të palës paditëse, ka përjashtuar ekspertin tjetër, shtetasin F.S., por në vendimin e saj, në vlerësimin e çështjes, i referohet aktit të ekspertimit të përgatitur nga i njëjti ekspert.
- 8.2. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Kolegjit Civil nuk i ka cituar plotësisht shkaqet e ngritura në rekurs nga kërkuësit, si dhe nuk i ka marrë në shqyrtim dhe nuk i ka vlerësuar ato. Po ashtu, Kolegji Civil nuk ka marrë në shqyrtim dhe nuk ka vlerësuar as shkaqet e ngritura në aktin parashtime të datës 12.11.2025. Kërkuësit në aktet e paraqitura pranë Gjykatës së Lartë kanë ngritur shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-së, të tilla si shkeljet e rënda të normave procedurale nga gjykata e apelit, për sa i përket mosformimit të drejtë të bashkëndërgjyqësisë, papajtueshmërisë për caktimin e ekspertit H.B., moszbatimit të detyrave të lëna më parë nga Gjykata e Lartë, që lidheshin me verifikimin e pronësisë së paditësit dhe të drejtën e pronësisë të kërkuësve, si dhe parimit të kontradiktoritetit, si pjesë të procesit të rregullt ligjor. Edhe pse e gjendur përpara këtyre pretendimeve për shkelje nga gjykata e apelit, të cilat e bënin të pavlefshme vendimmarrjen e saj, Gjykata e Lartë nuk i ka marrë në analizë dhe nuk ka arsyetuar në lidhje me to.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuësve

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi

gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Kriteret paraprake të legjitimitit janë të natyrës kumulative, ndaj, në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Kolegji evidenton se gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitit, në varësi të elementeve dhe veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë dhe shterues për kërkuesin. Thënë ndryshe, mund të ndodhë që në shqyrtimin paraprak të një çështjeje të verifikohet mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, duke sjellë si pasojë moskalimin e saj në seancë plenare.

11. Në kuptim të sa më sipër, në vlerësimin paraprak të respektimit të kriterëve të legjitimitit për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues, në drejtim të pretendimeve të parashtruara nga kërkuesit në mbështetje të ankimit kushtetues individual, Kolegji vëren se, në thelb, ata kanë pretenduar cenimin e *parimit të paanshmërisë dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*.

12. Për sa i përket *parimit të paanshmërisë*, sipas kërkuesve, ai është cenuar për shkak se eksperti H.B., i caktuar nga gjykata e apelit në rigjykimin e çështjes, ishte në kushtet e papajtueshmërisë, pasi e ka dhënë më parë mendimin e tij gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë. Po sipas kërkuesve, gjykata e apelit, me kërkesë të palës paditëse, ka përjashtuar ekspertin tjetër, shtetasin F.S., por në vendimin e saj, në vlerësimin e çështjes, i referohet aktit të ekspertimit të përgatitur nga i njëjti ekspert.

13. Gjykata ka pohuar se akti i ekspertimit është një provë shkencore, që, edhe pse mbart në vetvete shumë avantazhe, do të mbetet një provë si gjithë llojet e tjera të provave që do të marrë vlerën dhe fuqinë e saj provuese vetëm mbasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm e çmojnë atë. Çmuarja e provës, pra dhe i asaj me ekspert, bëhet duke nxjerrë vlerën e saj provuese në koherencë me provat e tjera të procesit gjyqësor. Në këtë aspekt, Gjykata ka vlerësuar se mendimet e ekspertit përbëjnë vetëm një këshillë për gjykatat, të cilat nuk janë aspak të detyruara që të pranojnë *a priori* këto mendime, përveçse kur i bindin. Fakti se eksperti ofron mendime të specializuara për gjykatën në një fushë jo juridike, bën që mendimi i ekspertit të tërheqë vëmendje më të madhe në momentin e çmuarjes së tij nga ana e gjykatave të zakonshme dhe se këto të fundit duhet të argumentojnë me hollësi mendimin e kundërt. Nëse

ato nuk pranojnë mendimin e ekspertit, duhet të paraqesin argumente bindëse, por kjo nuk do të thotë se gjykatat duhet të pajtohen gjithmonë me konkluzionet e ekspertëve. Pra, gjykatat përfundimet e nxjerra nga ekspertët i shqyrtojnë në kontekstin e të gjitha rrethanave të tjera të çështjes (*shih vendimin nr. 45, datë 23.07.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Duke u nisur nga këto vlerësime, si dhe bazuar në argumentet e kërkuësve, Kolegji fillimisht konstaton se, në thelb, pretendimet e tyre në drejtim të parimit të paanshmërisë kanë të bëjnë me mënyrën e vlerësimit të provave (aktit të ekspertimit) nga gjykata e apelit dhe çmuarjen e tyre prej saj, pra me themelin e çështjes që ka pasur për gjykim ajo gjykatë, të cilave u ka dhënë përgjigje të arsyetuar. Gjykata ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit interpretimi i ligjit material e procedural, zbatimi i tij në çështjet konkrete, çmuarja e provave, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes të të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit dhe të çmuarjes së provave për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 17, date 10.04.2025; nr. 76, datë 04.12.2017; nr. 4, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Po ashtu, në rastin konkret, referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, Kolegji konstaton se gjatë gjykimit në gjykatën e shkallës së parë, kjo e fundit, për të sqaruar faktet që kanë lidhje me mosmarrëveshjen objekt gjykimi përpara saj, ka caktuar ekspertët F.S. dhe H.B., të cilët, më pas, kanë përgatitur aktin e ekspertimit, mbi bazën e të cilit ajo gjykatë ka disponuar në vendimin e saj për zgjidhjen e çështjes. Sipas të njëjtave akte, konkretisht procesverbaleve të seancave gjyqësore, rezulton se gjykata e apelit, në seancën e datës 19.05.2016, ka vlerësuar se të njëjtët ekspert, F.S. dhe H.B., duhet të thirreshin për të sqaruar aktin e ekspertimit. Në seancën e datës 14.06.2016, gjykata e apelit u ka dhënë ekspertëve pikat e aktit të ekspertimit që duhet të sqaronin. Në vijim, në seancën e datës 29.06.2016, pala paditëse në proces ka ngritur pretendime për ekspertet, duke kërkuar përjashtimin e tyre. Ky pretendim i palës paditëse është kundërshtuar nga avokati i kërkuësve (palë e paditur në proces), me argumentin se ata kishin qenë që në gjykimin e çështjes në gjykatën e shkallës së parë dhe se pala paditëse nuk kishte ngritur asnjë pretendim për ta, por e kërkonte përjashtimin e tyre vetëm në atë moment. Gjykata e shkallës së parë ka pranuar pjesërisht kërkesën e palës paditëse, duke përjashtuar vetëm ekspertin F.S. dhe në vend të tij ka caktuar ekspertin tjetër L.Sh. Për këtë ndryshim janë pyetur edhe palët në proces, kërkuësit, të cilët nuk kanë shprehur asnjë kundërshtim.

16. Për sa më lart, Kolegji vëren se eksperti i kundërshtuar nga kërkuesit nuk ka kryer një akt të ri ekspertimi, por është thirrur nga gjykata e apelit për të sqaruar aktin e ekspertimit të kryer gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë. Po ashtu, Kolegji konstaton se dhe pse gjatë gjykimit në gjykatën e apelit eksperti H.B. është kundërshtuar nga pala paditëse në proces, kërkuesit, nëpërmjet mbrojtësit të tyre, e kanë kundërshtuar përjashtimin e tij me argumentin se ai ishte caktuar që në gjykimin në gjykatën e shkallës së parë dhe pala paditëse nuk mund ta kërkonte në atë moment përjashtimin e tij. Në këtë kuptim, Kolegji evidenton se vetë kërkuesit, edhe pse i kanë pasur të gjitha mundësitë të kërkonin përjashtimin e ekspertit H.B. gjatë gjykimit në gjykatën e apelit, nuk e kanë kërkuar një gjë të tillë, por, përkundrazi, kanë kundërshtuar kërkesën e bërë nga pala paditëse për përjashtimin e tij. Ndërkohë, në lidhje me këtë pretendim të tyre, për papajtueshmërinë e ekspertëve, kërkuesit kanë marrë përgjigje të arsyetuar edhe nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesve për cenimin e parimit të paanshmërisë është haptazi i pabazuar.

17. Kërkuesit kanë pretenduar dhe cenimin e *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi, sipas tyre, vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk i ka cituar plotësisht shkaqet e ngritura në rekurs dhe në aktet e tjera, si dhe nuk i ka marrë në shqyrtim dhe nuk i ka vlerësuar ato. Sipas kërkuesve, në aktet e paraqitura pranë Gjykatës së Lartë ata kanë ngritur shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-së, por ajo gjykatë nuk i ka vlerësuar ato.

18. Gjykata ka pohuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funkcioni i vendimit gjyqësor është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar duke u dhënë mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Me arsyetimin, gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo standardet kushtetuese, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 63, datë 23.09.2015; nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në lidhje me vendimet e Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, Gjykata ka pohuar se ato mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Po kështu, Gjykata në mënyrë konstante ka pohuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventuaisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 64, datë 01.10.2024; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Duke iu rikthyer rastit konkret, referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, Kolegji konstaton se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje nga rekursi i paraqitur nga kërkuesit në datën 30.11.2016. Po ashtu, Kolegji vëren se kërkuesit në datën 12.11.2025 kanë paraqitur pranë Gjykatës së Lartë edhe aktin parashtrime, në të cilin kanë parashtruar pretendimet e tyre në lidhje me çështjen. Referuar vendimit të Gjykatës së Lartë të kundërshtuar nga kërkuesit, Kolegji konstaton se Kolegji Civil i asaj gjykate, pasi ka paraqitur në mënyrë të përmbledhur pretendimet e kërkuesve të paraqitura si në rekurs, ashtu edhe në aktin parashtrime, i ka dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimit për cenimin e parimit të paanshëmërisë të ekspertit H.B., si dhe të ekspertit tjetër, duke e vlerësuar atë si të pabazuar dhe duke arsyetuar më tej se nga ana e gjykatës së apelit janë respektuar e zbatuar drejt dispozitat e ligjit material për zgjidhjen e çështjes në themel dhe është bërë një cilësim i drejtë i fakteve dhe rrethanave që lidhen me mosmarrëveshjen, si dhe është kryer një analizë juridike e plotë e provave në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Po ashtu, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vlerësimin e shkaqeve të rekursit ka arsyetuar se ai është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji, të listuara në mënyrë taksative në përmbajtje të nenit 472 të KPC-së.

22. Për sa më lart, ndryshe nga sa pretendojnë kërkuesit, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë ka zhvilluar një proces të rregullt, duke respektuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, duke parashtruar pretendimet e kërkuesve për vendimet e gjykatave më të ulëta, të parashtruara në rekurs dhe në parashtrime, shkaqe që rezultojnë të kenë gjetur pasqyrim në pjesën hyrëse të vendimit të Kolegjit Civil. Për sa i përket vlerësimit të këtyre shkaqeve në dhomën e këshillimit, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se kjo është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Dhoma e këshillimit njihet dhe si faza seleksionuese për shqyrtimin e rekursit në lidhje me

kushtet e pranueshmërisë, ku në mungesë të ekzistencës të të cilave Gjykata e Lartë disponon për mospranimin e tij, duke i dhënë kështu fund shqyrtimit (*shih vendimet nr. 64, datë 01.10.2024; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 26, datë 27.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në vlerësimin e Kolegjit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, edhe pse me një arsytim të kufizuar, ka vepruar në përputhje me rolin e tij dhe në ushtrim të funksionit si gjykatë e ligjit, si dhe në zbatim të dispozitave procedurave që rregullojnë atë formë gjykimi, duke vlerësuar se shkaqet e rekursit të ngritura nga kërkuesit nuk janë të tilla që të bëjnë të cenueshëm procesin gjyqësor të zhvilluar në gjykatën e apelit, për rrjedhojë duke lënë në fuqi interpretimin dhe zbatimin e ligjit nga Gjykata e Apelit Durrës. Po ashtu, Kolegji konstaton se arsyetimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk rezulton të jetë alogjik ose haptazi i paarsyeshëm, pra që të vërë në dyshim vetë thelbin e së drejtës për gjykim të drejtë, dhe vendimi i tij që ka vendosur mospranimin e rekursit në mungesë të shkaqeve ligjore nuk vë në dyshim të drejtën për proces të rregullt. Duke vendosur mospranimin e rekursit për shkak se nuk përmbante shkaqet ligjore, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në thelb, u ka dhënë përgjigje kërkuesve për pretendimet e tyre të ngritura në recurs. Në këtë kuptim, Kolegji vëren se kërkuesit kanë marrë përgjigje të arsyetuar për të gjitha pretendimet e tyre.

24. Ndërsa, për sa i përket argumentit të kërkuesve se në aktet e paraqitura pranë Gjykatës së Lartë ata kanë ngritur shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-së, por ajo gjykatë nuk i ka vlerësuar, Kolegji konstaton se sipas nenit 485, pika 1, shkronja “a”, të KPC-së, pas shqyrtimit të çështjes, Gjykata e Lartë vendos mospranimin e rekursit në rastet kur është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikon neni 472 i këtij kodi. Në rastin konkret, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesit, me arsyetimin se ai nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 472 i KPC-së. Për rrjedhojë, duke pasur parasysh natyrën seleksionuese të shqyrtimit në dhomën e këshillimit, si dhe faktin se arsyetimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në vlerësimin e shkaqeve të rekursit nuk duket arbitrar dhe nuk vë në dyshim të drejtën për proces të rregullt, Kolegji evidenton se Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me legjislacionin procedural. Nisur nga kjo, Kolegji vlerëson se argumenti i sjell nga kërkuesit nuk mbështet pretendimin e tyre për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor.

25. Për rrjedhojë, bazuar në të gjithë arsyetimin e mësipërm, Kolegji çmon se edhe pretendimi i kërkuesve për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë është haptazi i pabazuar.

26. Në këndvështrim të sa më lart, për shkak të karakterit kumulativ të tyre, Kolegji vlerëson se nuk është i nevojshëm analizimi i mëtejshëm i plotësimit të kriterëve të tjera të legjitimitetit të ankimit kushtetues individual të kërkuesve.

27. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuësve nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.